



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 03-111/01-119778/23

Data: 13.06.2023

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 90/2010), nenit 5, pikës c) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, nenit 68 paragrafi 7 të Ligjit për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 8/2019), nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Prishtinës shpallë:

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Titulli i vendit të punës	Vend i lirë / Zëvendësim	Numri i pozitive
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për Teknologji informative	Vend i lirë	3
2	ShFMU	Mësimdhënës/e për Teknologji informative	Zëvendësim	3
3	ShML	Mësimdhënës/e për Teknologji informative	Zëvendësim	1
4	ShFMU	Mësimdhënës/e për Edukatë Muzikore	Zëvendësim	1
5	ShFMU	Mësimdhënës/e për Edukatë Fizike	Zëvendësim	4
6	ShFMU	Mësimdhënës/e për Edukatë Figurative	Zëvendësim	1
7	ShML	Mësimdhënës/e për Hotelieri	Vend i lirë	1
8	ShML	Mësimdhënës/e për Balet	Vend i lirë	1
9	ShML	Mësimdhënës/e për Valle Popullore	Vend i lirë	1
10	ShML	Mësimdhënës/e për Violonçelo	Vend i lirë	1
11	ShML	Mësimdhënës/e për Fiziarmunikë	Vend i lirë	1
12	ShML	Mësimdhënës/e për Solfexho	Vend i lirë	2
13	ShML	Mësimdhënës/e për Piano	Vend i lirë	3
14	ShML	Mësimdhënës/e për Violinë	Vend i lirë	1
15	ShML	Mësimdhënës/e për Trumpete	Vend i lirë	1
16	ShML	Mësimdhënës/e për Piano	Zëvendësim	2
17	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor në lëminë mjekësore të përgjithshme	Zëvendësim	2
18	ShML	Mësimdhënës/e për praktikë profesionale Infermier (Instruktur)	Vend i lirë	1
19	ShML	Mësimdhënës/e për profilin arsimor të Fizioterapisë	Zëvendësim	1

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në KK Prishtinë);
- USB - Të gjitha dokumentet të skanohen dhe të vendosen në USB, e cila do të ruhet në arkivim dhe nuk do të kthehet prapa;
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftim ose pasaportë);
- Rezumeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit të noterizuara;
- Certifikatat e noterizuara (certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë jo më të vjetra se gjashtë (6) muaj nga data e diplomimit);
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës së punës në institucionet edukative arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit arsimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse të MASHTI-it (UA Nr. 05/2015 dhe UA nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Teknologji informative në shkollë të mesme të ulët:**
 - Programi/dega Teknologji-informatikë
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
 - Programi matematikë-informatikë
 - Niveli master arsimor – (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Teknologji informative në shkollë të mesme të lartë:**
 - Programi i mësimdhënies në teknologji dhe TIK:
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
 - Programi i shkencave kompjuterike
 - Niveli master arsimor – (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Edukatë muzikore në shkollë të mesme të ulët:**
 - Niveli master – pedagogji e përgjithshme muzikore (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor – Pedagogji e përgjithshme muzikore (katërvjeçar 240 ECTS).

- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të ulët për Edukatë fizike në shkollë të mesme të ulët:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të ulët dhe të lartë për Edukatë figurative në shkollë të mesme të ulët dhe të lartë:**
 - Niveli master arsimor – Niveli master (300 ECTS, Programi: Pikturë/Skulpturë/Grafikë);
 - Sistemi katërvjeçar (Programi: Pikturë/Skulpturë/Grafikë) ;
 - Baçelor – (katërvjeçar 240 ECTS, Programi: Pikturë/Skulpturë/Grafikë).
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Hoteleri në shkollë të mesme të lartë:**
 - MSc. i turizmit dhe hotelierisë;
 - Ekonomist i dipl. i turizmit dhe hotelierisë.
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Balet në shkollë të mesme të lartë:**
 - Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara përkatëse)
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Valle popullore në shkollë të mesme të lartë:**
 - Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara përkatëse).
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Violonçello në shkollë të mesme të lartë:**
 - Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës).
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Fizarmonikë në shkollë të mesme të lartë:**
 - Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës).
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Solfexho në shkollë të mesme të lartë:**
 - Master i muzikës (në kompozim, teori) studimet e kompletuara;
 - Master i muzikës (pedagogji e përgjithshme muzikore – punimi i masterit nga lënda e Solfezhit);
 - Master i muzikës (drejtimet instrumentale);
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Piano në shkollë të mesme të lartë:**
 - Master i muzikës – Piano (studimet e kompletuara për instrumentin përkatës);
- **Kriteret e kualifikimit për mësime të mesme të lartë për Violinë në shkollë të mesme të lartë:**
 - Fakulteti i Arteve – Master i muzikës (Studimet e kompletuara për instrumentin përkatës).

- Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Trombon në shkollë të mesme të lartë:
 - Master i muzikës – (studimet e kompletuara për instrumentin përkatës);
- Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për profilin arsimor në lëmin mjekësore në shkollë të mesme të lartë:
 - Mjeku specialist;
 - Mjeku.
- Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për praktikë profesionale në profilin arsimor – Infermieri (Instruktor) në shkollë të mesme të lartë:
 - Master i infermierisë dhe mamive;
 - Mjek specialist;
 - Mjeku.
- Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për profilin arsimor në Fizioterapi në shkollë të mesme të lartë:
 - Master i fizioterapisë;
 - Fizioterapeut i diplomuar.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së;
- Të mos e shfrytëzoj pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
- Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
- I punësuar i është obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.

- I punësuarit nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Punë dhe detyra të tjera shtesë të caktuara nga drejtori i shkollës dhe detyra të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të arsimit parauniversitar.

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit të konkursit më 13.06.2023 deri më datën 27.06.2023;
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;
- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë **diplomat e nostrifikuara në MASHTI**;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit (numrin e protokollit), e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit të stafit arsimor për vitin shkollor 2023/2024 (Shtator 2023 - Gusht 2024);
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët e mbledhura në fazat vlerësuese renditin kandidatët me më shumë pikë që do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e Komunës të Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> (konkurset) dhe përmes e-mailit (bazuar në aplikacionin e kandidatit);
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare të Komunës të Prishtinës;
- Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve, e cila konsiderohet si listë pritëse;



-
- Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë nuk do të jetë domosdoshmërisht më datën 01.09.2023, por në varësi të lirimit real të vendit të punës (datës së pensionimit, pushimit të lehonisë, etj).
 - Anëtarët e komuniteteve joshumicë dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.